

# BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QËNDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË

Anetare e Qendres Nderkombetare te Kerkimeve  
per Vleresimin e Tendencave Ekonomike, Zurich

*CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT TIRANA*

*A Corporate Member of the Centre for International  
Research on Economic Tendency, Zurich (CIRET)*

Rezultatet e vrojtimit të  
biznesit dhe konsumatorëve  
Nr. 10, Qershor 2004

[www.qkzh.org](http://www.qkzh.org)

*Business and Consumer  
Survey Results  
No 10, June 2004*

Në këtë numër:  
Zhvillimet ne sektorin e industrise  
perpunuese dhe ndertimit



*In this number:  
Development in manufacturing and  
construction sectors*

## KLIMA E BIZNESIT/ BUSINESS CLIMATE

### INDUSTRI PERPUNUESE

NE PERMIRESIM

### MANUFACTURING

IMPROVING

### NDERTIM

E PRANUESHME

### CONSTRUCTION

SATISFACTORY

## VESHTIRESITE E BIZNESIT/ BUSINESS CONSTRAINS

### INDUSTRI PERPUNUESE

VESHTIRESITE FINANCIARE, ENERGJIA  
ELEKTRIKE, INFRASTRUKTURA

### MANUFACTURING

FINANCIAL DIFFICULTIES, ELECTRICITY,  
INFRASTRUCTURE

### NDERTIM

PROÇEDURAT PER LEJE NDERTIMI,  
KONKURENCA E PANDERSHME NGA  
TREGU I ZI

### CONSTRUCTION

BUILDING LICENSED PROCEDURES,  
UNFAIR COMPETITION BY BLACK  
MARKET

## Rreth autorit

QKZH është një organizatë jo fitimprurëse dhe jo partiake e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27/03/2001. Qëllimi i QKZH është të kryej studime dhe analiza ekonomike rreth zhvillimeve dhe performancës së biznesit duke u mbështetur në anketime të biznesit. Duke analizuar ecurinë e biznesit synohet të ndihmohen institucionet publike dhe komuniteti i biznesit për të përcaktuar politika më të mira që i shërbejnë përmirësimit të klimës së biznesit dhe rritjes së investimeve.

Nga muaji janar 2004, QKZH është pranuar anetare e Qendres Nderkombetare të Kerkimeve për Vlerësimin e Tendencës Ekonomike, Zurich

## Rreth këtij numri

Në këtë numër është pasqyruar situata e përgjithshme e biznesit në sektorin e industrisë perpunuese dhe ndertimit për vitet 2002-2003 dhe 3-mujorin e parë të vitit 2004. Organizimi i anketimeve, metodologjia e aplikuar nga QKZH janë në përputhje me metodologjinë e hartuar nga Komisioni Europian dhe të rishikuara nga keshilltari i QKZH z. Franz-Josef Klein. Firmat e perzgjedhura, janë pjesë e një grupi të konsoliduar, ku për muajin prill janë kontaktuar rreth 600 firma në industrinë perpunuese dhe ndertim, të shtrira në rrethet Tiranë, Durrës, Shkoder, Elbasan, Fier dhe Vlorë. Në këtë numër është analizuar ecuria e biznesit për vitin 2003.

## About the author

CRD Tirana is an independent, non-profit and non-partisan organisation, duly registered at the Court of Tirana in 27.03.2001. The aim of CRD is to create and disseminate knowledge about economic development and business performance to help public institutions and business community to designate good policies for a better society. The CRD conducts business and consumer surveys, organises meetings and publishes research results about recent business development, factors limiting production activity and future investment.

From January 2004, CRD has become a corporate member of Centre for International Research on Economic Tendency Surveys, Zurich (CIRET).

## About this number

In this number is given a general assessment of business situation in manufacturing sector and construction over the 2002-2003 period and the first quarter of 2004. The methodology applied by CRD for conducting business surveys are in conformity with the recommendation of the European Commission and supervised by CRD special adviser Franz-Josef Klein. Responded firms are part of a consolidated sample of 600 firms manufacturing and construction sector, distributed in most representative districts of Tirana, Durrës, Shkoder, Elbasan, Fier and Vlorë.

### Grupi i punës/Working group:

Drejtores / Director:

Mirlinda Rusi (Gajo)

Keshilltar special / Special Adviser: Franz-Josef Klein

Anëtarët e grupit / Group's members:

Albert Gajo, Rozi Poga (Beqiri), Jonida Naska, Bexhet Hyka

### QKZH/CRD TIRANA

Adresa / Address:

Rr. "Luigj Gurakuqi",

P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1

PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax ++355 (0)4 230 445,

Mobile: ++355 (0)69 22 40 906,

E-mail: info@qkzh.org

Bank account: BIA Tirana, 19602

Emri/Name \_\_\_\_\_

Adresa/Address \_\_\_\_\_

Tel & Fax \_\_\_\_\_

Mobile \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Numri i kopjeve/Number of copies \_\_\_\_\_

Ne kerkojme te abonohemi per:

We request subscription for:

Per 20 numra/20 editions: \$ 50

Per 10 numra/10 editions: \$ 25

## Zhvillimet ne sektorin e industrise perpunuese Development in manufacturing sector

FIGURA 1: Treguesi i besueshmerise ne industri  
Manufacture confidence indicator




FIGURA 1a: Treguesi i besueshmerise ne industri (<10 pun)  
Manufacture confidence indicator (< 10 empl)




FIGURA 2: Vleresimi i aktivitetit te prodhimit  
Assesment of production activity




FIGURA 3: Vleresimi i nivelit te kontraktiveve  
Assesment of order-books





FIGURA 3a: Vleresimi i nivelit te kontraktiveve (<10 pun)  
Assesment of order-books (<10 empl)



Source: CRD Tirana

### Klima e biznesit: ne permiresim Business climate: improving

Treguesi i besueshmerise ka tendence rritjeje gjate tremujorit te pare te vitit 2004, perkatesisht ne vleren prej 20 pikesh nga 3 pike qe shenonte balanca ne fillim te ketij viti (shih figuren 1).

Ky tregues, duke u vleresuar ne kohe shikohet te kete luhatje ciklike, gje qe tregon per nje paqendrueshmeri te klimes se biznesit ne sektorin e industrise perpunuese. Kjo vjen si rrjedhoje e situates makroekonomike dhe politike me nje ndikim ne mjedisin shqiptar te biznesit.

Duke shkuar me ne brendesi te analizes, duke vecuar pergjigjet e menaxhereve per mikro-ndermarrjet (me me pak se 10 punonjes), te cilat jane te shumta ne numer ne sektorin e industrise perpunuese, verehet qe treguesi i besueshmerise eshte gjithashtu me luhatje, por qe jane ne vlera negative (shih figuren 1a). Keto zhvillime tregojne pasigurine e ketyre firmave ne mjedisin ku ato operojne.

Nga krahasimi i dy figurave 1 dhe 1a mund te konkludohet se ne vleresimin e treguesit te besueshmerise per industrine perpunuese ndikimin me te madh e japin firmat e mesme dhe te medha


### Aktiviteti i prodhimit: ne renie Production activity: decreasing

Aktiviteti prodhues ne 3 mujorin e pare te ketij viti verehet te kete pesuar nje renie. Kjo renie eshte vertetuar ne 2 anketime te njepasnjeshme. Megjithate, kjo situat mund te shpjegohet me faktin se ne 3 mujoret e pare te vitit ka arsye sezonale qe ndikojne ne nje kerkese konsumatore me te ulet, si rrjedhim transmetohet ne nje rritem prodhimi me te ulet (shih figuren 2).

### Niveli i kontraktiveve: i pamjaftueshem Order-books: not satisfactory

Figura 3 tregon se niveli i kontraktiveve eshte ne nivele jo te pelqyeshme por me nje tendence ne rritje ne krahasim me periudhen e fillimit te vitit, duke perfshire ketu edhe gjashtemujorin e pare te vitit te kaluar. Per bizneset e medha kjo eshte me e dukshme. Vleresimi i ketij treguesi po ti referohemi firmave te vogla (me me pak se 10 punonjes) mbetet ne nivele te uleta dhe ka vlera negative (shih figuren 3a). Duke e analizuar ne kohe kete tregues teper te rendesishem per keto firma verehet se ato nuk jane mesuar te punojne me kontrata dhe vazhdojne ta kene te veshtire te kene nivel te kenaqshem kontraktimesh.


**FIGURA 4: Niveli i kontratave per eksport**  
*Assesment of export order-books*




**FIGURA 4a: Niveli i kontratave per eksport (<10 pun)**  
*Assesment of export order-books (< 10 empl)*




**FIGURA 4b: Parashikimi i kontratave per export**  
*Assesment of export expectation*



**FIGURA 5: Vleresimi i produkteve te gatshme**  
*Assesment of stocks*



**FIGURA 5a: Vleresimi i produkteve te gatshme (<10 pun)**  
*Assesment of stocks (< 10 empl)*



Source: CRD Tirana

**Kontraktimet per eksport:ne nivele te praneshme**  
**Export order-books: in satisfactory levels**

Balanca e pergjigjeve per kontraktimet ne eksport ne 3 mujorin e pare te ketij viti duket se eshte ne nivele te praneshme me nje tendence ne rritje ne krahasim me 3 muaj me pare. Nga figura 4 shohim se mesatarja e balancave te pergjigjeve ne lidhje me nivelin e kontraktimeve per eksport ne te gjitha perudhat mbetet ne vlera negative, por kohet e fundit nga pikpamja e tendences per tremujorin qe studiojme (prill 2004) ka nje tendence rritjeje nga -10 ne periudhen para ardhese ne 0 per kete periudhe. Ky fakt shpreh tentativen e bizneseve te medha prodhuese vendase per te menduar per te rritur eksportet e produkteve te tyre. Ne te njejten kohe figura 4a shpreh situaten e mikro ndermarrjeve (me me pak se 10 punonjes) ne lidhje me treguesin e kontraktimeve per eksport. Firmat e vogla duket se jane ose te pa interesuara ne eksport ose kane vleresime pesimiste per te pasi nuk arrijne te gjejne tregun dhe rruget e pershtatshme.

Edhe indikator i parashikimit te nivelit te kontraktimeve per eksport per 3 mujaj ne vijim parashikohen ne rritje (shih figuren 4b) ndersa per mikro-ndermarrjet (me me pak se 10 punonjes) konfirmojne gjithashtu se ato nuk kane aksesin e duhur ne tregun jashtem, dhe per me teper ato nuk jane edhe optimiste se pozicioni i tyre ne eksport do te ndryshoje per 3 mujorin e ardhshem.

**Gjendja e produkteve te gatshme: duke u ulur**  
**Stocks: decreasing**

Balanca e pergjigjeve per produktet e gatshme tregon se gjendja e tyre vazhdon te ulet me nje rritem aferesisht te barabarte me mesataren e balancave te pergjigjeve per periudhen janar 2002 - tetor 2003. Per mikro ndermarrjet (me me pak se 10 punonjes) gjendja e produkteve te gatshem duket se po ulet akoma edhe me shume (shih figuren 5a). Kjo situatë duket se vjen si rezultat i pasigurise qe kane firmat ne pergjithesi per shitjen e produkteve te gatshme duke parandaluar ne kete menyre nje perkeqesim te situates se tyre financiare.

**Parashikimi i aktivitetit te biznesit: ne rritje**

**Expectation of business activity: increasing**

Rezultatet e anketes ne muajin prill 2004 tregojne se aktiviteti i pritshem i biznesit per 3 mujorin e dyte duket se eshte ne rritje. Keto rezultate konfirmojne tendencen pozitive qe tregohet nga klima e biznesit ne sektorin e industrise perpunuese (shiko figuren 1). Ky parashikim optimist eshte me i dukshem ne firmat e medha dhe ato te konsoliduara, por edhe tek mikro-firmat (me me pak se 10 punonjes - shih figuren 6a) ku ky tregues ka tendence permiresimi dhe pikerisht balanca e vlerave per kete tregues nga -5 per janarin shkon ne + 27 per prillin 2004. Parashikimi optimist per aktivitetin e biznesit ne 3 muajt e ardhshem eshte nje nga treguesit baze qe ndikon ne permiresimin e klimes se biznesit, duke marre parasysh qe niveli i kontraktimeve eshte po ashtu ne rritje.

**Parashikimi i çmimeve te shitjes: i pa ndryshuar**

**Price expectation: stable**

Anketimi ne muajin prill tregon se niveli çmimeve te shitjes ka nje tendence uljeje pasi balanca e pergjigjeve per kete tremujor eshte ne vleren prej 1 pike. Duket se mikro-ndermarrjet jane nen nje presion me te madh nga konkurenca, pasi balanca e pergjigjeve per kete pyetje eshte negative prej me se nje viti (shiko figuren 7a).

**Parashikimi i punesimit: ne rritje**

**Employment expectation: increasing**

Nga rezultattet e anketimit ne muajin prill 2004, shikohet se parashikimi i punesimit per 3 muajt e ardhshem do te jete perseri ne rritje, pasi balanca e pergjigjeve eshte ne vleren prej +9 pikesh (shih figuren 8). Megjithate ky parashikim eshte ne nivele me te uleta nga mesatarja e balancave per periudhen janar 2002 - tetor 2003, gje qe tregon per nje ngadalesim te rritmeve te rritjes se punesimit ne pergjithesi. Duhet theksuar se parashikimi i rritjes se numrit te punonjesve eshte nje tregues indirekt qe tregon permiresim te klimes se biznesit, qe do te coje njekohesisht ne rritjen e nivelit te prodhimit.

FIGURA 6: Parashikimi i aktivitetit te biznesit  
Expectation of business activity




FIGURA 6a: Parashikimi i aktivitetit te biznesit (< 10 pun)  
Expectation of business activity (< 10 empl)




FIGURA 7: Parashikimi i çmimeve te shitjes  
Selling prices expectations




FIGURA 7a: Parashikimi i çmimeve te shitjes (< 10 pun)  
Selling prices expectations (< 10 empl)






FIGURA 8: Parashikimi i punesimit  
Employment expectation




Source: CRD Tirana


**FIGURA 9: Vleresimi i nivelit te prodhimit ne muaj**  
*Assessment of months of production*



**FIGURA 9a: Niveli prodhimit ne muaj (<10 punonjes )**  
*Months of production (< 10 empl)*



**FIGURA 10: Shfrytezimi i kapaciteteve prodhuese**  
*Capacity utilisation*




Source: CRD Tirana

Ne muajin prill 2004, ne baze te kontratave te lidhura niveli i prodhimit ne muaj eshte 8 muaj. Ky nivel eshte pothuajse i barabarte me mesataren e verejtur per vitetet 2002 dhe 2003. Kjo tregon se firmat jane mesatarisht 8 muaj te mbuluar me pune. Ndersa ky tregues per mikro-ndermarrjet eshte rreth 6 muaj (2 muaj me i vogel se totali), nje nivel ky prej 1 muaji me te ulet sa ceshte shenuar ne muajin janar 2004 (shiko figuren 9a). Edhe ky tregues konfirmon se mikro-ndermarrjet duke patur nje nivel me te ulet te kontraktimeve, kane edhe nje pasiguri me te madhe.


Figura 10 tregon se ne muajin prill 2004 shfrytezimi i kapaciteteve prodhuese eshte ne nivelin 49%. Ky nivel eshte pothuajse 10% me i ulet se shfrytezimi i kapaciteteve ne muajin janar 2004, e cila konfirmon se firmat ne industrine perpunuese kane nivele me te uleta prodhimi se 3 mujorin e 4-te te vitit 2003. Po keshtu kjo situatë eshte edhe per mikro-ndermarrjet ku niveli i shfrytezimit te kapaciteteve prodhuese ka rene ne 36% nga 46% qe ishte 3 muaj me pare. Pra, si konkluzion nxjerrim se niveli i prodhimit ne 3 muajt e pare mund te kete pesuar nje ulje te lehte.

**FIGURA 11: Niveli i kontraktimeve**  
*Last development of order -books*




Source: CRD Tirana


**FIGURA 11a: Niveli i kontraktimeve (<10 pun)**  
*Last development of order -books (<10 empl)*



**FIGURA 12: Vleresimi i kapaciteteve prodhuese**  
*Assessment of production capacity*



**FIGURA 12a: Vleresimi i kapaciteteve prodhuese (<10 pun)**  
*Assessment of production capacity (<10 empl)*




Source: CRD Tirana

Pergjigjet ne lidhje me nivelin e kontraktimeve ne 3 muajt e kaluar tregojne vlera shume me te ulta ne krahasim me pergjigjet per nivelin e kontraktimeve aktule (per te njejten periudhe te nje viti me pare), por ka permiresime te lehta ne krahasim me rezultatet e anketimit te tremujorit te kaluar (shih figuren 11). Ky tregues eshte mjaft i rendesishem pasi tregon qe kemi nje ulje te aktivitetit prodhues ne pergjithesi ne 3 mujorin e pare. Duke ju referuar dhe vleresimit te kapaciteteve prodhuese rezulton se firmat kane mjaft mundesi per te perballuar kontraktime te reja (shih figuren 12). Ne te njejten menyre, po te vecojme firmat me numer punonjesish me te ulet se 10 ato jane me vlera te thella negative (-55 pike) ne kontraktimin e punes (shih figuren 11a). Po te shikojme njekohesisht si i vleresojne ato kapacitetet e tyre prodhuese (figura 12a) rezulton se ato kane kapacitete me se te mjaftueshme.


Ne pyetjen ne lidhje me pozicionin konkurues te firmave (figurat 13 dhe 14) shikohet qarte se pozicioni i tyre konkurues eshte permiresuar ne lidhje konkurruesmerine e produkteve apo tregjeve me vendet e rajonit dhe eshte perqekesuar me vendet e EU.

**FIGURA 13: Pozicioni konkurrues ne tregun e EU**  
*Foreign competitive position inside EU*



Source: CRD Tirana

**FIGURA 14: Pozicioni konkurrues jashte tregut te EU**  
*Foreign competitive position outside EU*




### **Pengesat ne sektorin e industrise perpunuese** *Constraints within manufacturing sector*


Firmat e vogla ne pergjithesi jane me te ndjeshme dhe te pambrojtura kundrejt pengesave te ndryshme administrative apo faktoreve makroekonomike. Treguesit e ecurise se biznesit treguan se mikro-ndermarrjet aktualisht jane me pak optimiste per zhvillimet aktuale dhe per te ardhmen, vecanerisht po te krahasohen keto rezultate me ato te nje viti me pare.

Ndikimi i mungeses se infrastruktures vazhdon te jete nje pengese serioze per sektorin e industrise. Veshtiresite financiare (mungesa e likuiditetit) eshte problematike per firmat e medha por vecanerisht mbi 50% e firmave te vogla e konsiderojne kete pengese bllokuese per vazhdimin e prodhimit, si dhe pa mundesia per te perballuar marrjen e kredise pasi çmimi i saj duket se eshte relativisht i larte.


**FIGURA 15: Ndikimi i mungeses se infrastruktures**  
*The impact of lack of infrastructure*




**FIGURA 16: Veshitresite financiare**  
*Financial constrains*




**FIGURA 17: Veshitresite per te siguruar kredi**  
*Difficulties in obtaining credit*



**FIGURA 18: Ndikimi i legjislacionit financiar**  
*The impact of financial legislation*



**FIGURA 19: Ndikimi i mungesave te energjise elektrike**  
*The impact of shortages on electricity*



## Zhvillimet ne sektorin e Ndertimit *Development in Construction sector*

### **Klima e biznesit: e pranueshme** *Business climate: satisfactory*

Treguesi i besueshmerise ne sektorin e ndertimit ne prill te 2004 eshte pozitive prej 3 pikesh, por ka nje renie prej 11 pikesh ne krahasim me 3 muaj me pare. Kjo renie eshte kryesisht nga influenca e faktoreve sezonale. Po te heqim faktorin sezonal ne treguesin e besueshmerise do te shikohet se ky tregues mbetet i pandryshuar krahasuar me janarin e 2004, ku per kete periudhe ky rezultat mbetet ne nivele pozitive te pranueshme. Duke e krahasuar treguesin e besueshmerise ne muajin prill me mesataren e balancave te pergjigjeve shikohet gjithashtu nje tendence e lehte pozitive. Per ndermarrjet e vogla ndertuese ky indikator tregon pesimizem (shih figuren 20a).

### **Parashikimi i punesimit: ne rritje** *Employment expectation: increasing*


Indikator i parashikimit te punesimit per 3 muajt e ardhshem eshte faktor me rendesi qe ndikon ne vlersimin e treguesit te besueshmerise. Ky indikator me gjithse per periudhen e prillit 2004 ka nje renie me 5 pike ne krahasim me nje periudhe me pare, balancen e ka positive me 19 pike (shih figuren 21). E krahasuar me mesataren e balancave ne 2 vjetet e fundit parashikimi i punesimit ne 9 muajt e fundit eshte me i larte se kjo mesatare.

### **Niveli i kontraktiveve: jo i kenaqshem**


#### ***Order-books: not satisfactory***

Ne kontrast me treguesin e parashikimit te punesimit, niveli i kontraktiveve eshte negativ. Kjo renie e kontraktiveve vjen si pasoje e pengesave administrative (lejet e ndertimit) dhe faktore te tjere si p.sh. mungesa e kerkeses.


**FIGURA 20: Treguesi i besueshmerise ne ndertim**  
*The confidence indicator in construction sector*




**FIGURA 20a: Treguesi i besueshmerise ne ndertim**  
*The confidence indicator in construction sector*



**FIGURA 21: Parashikimi i punesimit ne ndertim**  
*Employment Expectation in construction sector*




**FIGURA 22: Vleresimi i nivelit te kontratave**  
*Assesment of order-books*



Source: CRD Tirana

**FIGURE 23: Vleresimi i nivelit te kontraktimeve ne muaj**  
*Work already contracted in months*




Source: CRD Tirana

**Koha e punes se kontraktuar: 10 muaj**  
*Work already contracted: 10 months*

Nisur nga niveli i kontratave te lidhura anketimi i muajit prill 2004 konfirmon faktin se firmat kane mesatarisht 10 muaj te siguruar me pune. Krahasuar me mesateren e balancave per 2 vjetet e fundit rezulton se firmat ne te gjitha periudhat e tyre ne pergjithesi kane patur rreth 8 muaj mbuluar me pune (shih figuren 23).

**Pengesat ne sektorin e ndertimit**  
*Constraints within constructing sector*

**FIGURA 24: Ndikimi i kerkeses**  
*The impact of demand*




**Ndikimi i mungeses se kerkeses: ne rritje**

*The impact of lack of demand: increasing*

Duke pare vlerat e faktoreve kufizues per periudhen e prillit 2004 verehet se nje ndikim negativ duket se po jep mungesa e kerkeses konsumatore, ku ajo eshte rritur ne 14 pike ne krahasim me 9 pike qe ishte ne muajin janar 2004. Per firmat e vogla kjo pengese eshte akoma me e madhe, duke u rritur ne 49% nga 26% qe ishte ky tregues 3 muaj me pare (shih figuren 24a).

**FIGURA 24a: Ndikimi i kerkeses (< 10 pun)**  
*The impact of demand (< 10 empl)*




**Sigurimi i lejeve te ndertimit: pengese ne rritje**

*Building licensing: deteriorating*

Nje pengese tjeter qe ndikon drejtperdrejt ne rritjen apo uljen e aktivitetit ndertues ne sektorin e ndertimit eshte dhe veshitresia ne marrjen e lejeve te ndertimit. Verehet se per periudhen nga janari ne prill 2004 kemi nje rritje te kesaj pengese ne vlerat perkatese nga 56% ne 69% e totalit te firmave ndertuese te intervistuar, duke u bere keshtu faktori me i rendesishem pengues ne ndertim. Drejtuesit e firmave pohojne se po hasin veshitresi te medha ne sigurimin e lejeve te ndertimit. Duke e ndjekur kete tregues ne kohe ne figuren 25 verehet se gjate janarit dhe prillit 2004 ky tregues arrin vlerat me te larta te tij, gje qe mund te çojë ne nje çrregullim ne menyre artificiale /te sforcuar te raportit kerkese-oferte te tregut te ndertimeve.

**FIGURA 25: Procedurat per leje ndertimi**  
*Building licensing procedures*



Source: CRD Tirana

**Konkurenca e pandershme: ne rritje**

***Unfair competition: increasing***

Pengese tjeter e rendesishme qe reflektohet per muajin prillin e 2004 eshte dhe konkurenca e pandershme nga tregu i zi. Efekti i ketij faktori eshte ne vlera te larta jo vetem per biznesin e vogel por dhe per ate te madh, ku ne muajin prill eshte e vleresuar nga rreth 50 % e drejtuesve ne pergjithesi, ndersa per firmat e vogla ky tregues eshte 53 %. Rritja e kesaj pengese ne menyre kaq te shpejte sjell pasoja negative per mbarvajtjen e punes ne kete sektor, pasi ai lidhet edhe me cilesine e materialeve ndihmese, e veçanerisht me fshehjen e rezultateve financiare te ndermarrjeve (rritjes se informalitetit).


**Situata makro ekonomike: e paqendrueshme**

***Macro-economic environment: unstable***


Pengese tjeter e cila per periudhen e fundit shikohet te jete perseri ne rritje eshte dhe ndikimi i situates makro ekonomike. Ky tregues kap vlerat e 28 pikeve ne prill nga 21 ne janar te 2004. Edhe ky tregues indirekt tregon pasigurine ose sensitivitetin qe kane investoret e ketij sektori ne situata te caktuara/ te paqendrueshme makroekonomike qe kalon vendi gjate periudhes se tij tranzitive te zhvillimit.

Mungesa e energjise elektrike (figura 28) eshte nga faktoret qe ka shenuar nje renie te konsiderueshme si pengese ne ndertim, pasi ai eshte perzgjedhur nga rreth 40% e firmave te intervistuar nga 70% qe ishte ky tregues ne muajin janar 2004.


**FIGURA 26: Konkurenca e pandershme nga tregu i zi**  
*Unfair competition by black market law*




**FIGURA 26a: Konkurenca e pandershme nga tregu i zi (<10 pun)**  
*Unfair competition by black market law (<10 empl)*



**FIGURA 27: Ndikimi i faktoreve makroekonomike**  
*The impact of macroeconomic factors*



**FIGURA 28: Ndikimi i mungesave te energjise elektrike**  
*The impact of shortages on electricity*



Source: CRD Tirana

## **Liber:**

Albert Gajo: Shqiperia Demokraci ne Deficit - Analize e zhvillimeve ekonomike, politike dhe institucionale  
Botim i QKZH, Tirane 2001

## **Lista e studimeve**

Vleresimi i veshitresive te biznesit ne sektorin e industrise – Shtator 2001, financuar nga UNIDO/UNDP

Vleresimi i ndikimit te NVM ne rritjen ekonomike ne Shqiperi: 1997 – 2000 – dhjetor 2002, financuar nga SEED/  
ETI

Vleresimi i aktivitetit te mikro-ndermarrjeve ne zonat periferike – gusht 2003, financuar nga Banka Boterore

Vleresimi e pengesave administrative ne sektrin e ndertimit – maj 2003, financuar nga SEED/Shoqata e ndertuesve  
te Shqiperise

Mbeshtetja e jashtme per NVM dhe roli i Agjensive Rajonale te Zhvillimit – Shtator 2003, financuar nga Chemonics  
International Inc./USAID

Veshtrim kritik mbi hartimin dhe zbatimin e programit te shpenzimeve buxhetore ne Shqiperi: 1994-2002 - tetor  
2003, financuar nga MSI/USAID

Integrimi i rinise ne tregun e punes: Pengesat dhe Veshitresite – qershor 2003, financuar nga Fondacioni per  
Shoqerine e Hapur (Fondacioni Soros)

Nxitja e zhvillimit te sektorit privat: Vleresimi i veshitresive dhe ndikimit te aktivitetit informal ne sektorin e  
sherbimeve – gusht 2003, financuar nga Partners/USAID

Opinionet dhe Qendrimi i Qytetareve per Reformen Arsimore ne Shqiperi - tetor 2003, financuar nga fondacioni  
per Shoqerine e Hapur (Fondacioni Soros)

Metodologjia e indikatorëve te performances se ndermarrjeve te vogla dhe te mesme - maj 2004, financuar nga  
SEED/IFC

## **INTRA-BALKAN CONSULTANT, Sh.p.k.**

Intra-Balkan Consultant sh.p.k. (IBC) ofron konsulence financiare dhe juridike për institucionet publike dhe private. IBC është veçanërisht e specializuar për kryerjen e analizave në fushën e zhvillimit të tregjeve dhe aktiviteteve të veçanta, përcaktimin e rreziqeve, studimin e kërkesës konsumatore për produkte apo shërbime të veçanta në Shqipëri dhe më gjërë, si dhe ndikimin e sistemit fiskal mbi aktivitetin e biznesit.

Ne jemi të sigurve se do te japim alternativën më të mirë për biznesin tuaj.

*Intra-Balkan Consultant Ltd (IBC) provides financial and legal consultancy service for public and private institutions. IBC is especially specialised for market research, risks appraisal, analysis of consumer demand for goods and services in Albania and other countries as well as the impact of fiscal legislation to businesses.*

*We are sure that we will give you the best solution for your business activity.*

Riprodhimi i pjesshem ose i plote i ketij botimi autorizohet ne kushtet e citimit te plote te burimit te informacionit dhe nje kopje te dergohet prane QKZH.

*Part or full reproduction of this publishing permitted only if source is stated and copy is sent to the CRD*